

VENDIM
Nr. 289, datë 23.12.2024

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “DRIBEN” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1857/18 prot., datë 23.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Driben’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Driben” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1857 prot., datë 3.9.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet prodhues 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 203, datë 27.9.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.10.2024 dhe 2.10.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.10.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 2057, datë 8.10.2024, është njoftuar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për fillimin e kësaj procedure.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, vendimeve të Bordit të ERE-s nr. 232, datë 30.10.2024, dhe nr. 245, datë 14.11.2024, u vendos zgjatja e vendimarrjes deri jo më vonë se data 21.12.2024.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën nr. 1857/16 prot., datë 16.12.2024, pas shqyrtimit të të cilit me *email*-in nr. 1857/17 prot., datë 17.12.2024, i është kërkuar shoqërisë të depozitojë dokumentacionit si vijon:

- Njoftimi i depozituar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në lidhje me ndryshimin e vlerës së planit të biznesit, në referencë të përcaktimeve të nenit 8, pika 2 të Kontratës nr. 10518 rep., nr. 4880 kol, datë 28.12.2023, të nënshkruar me MIE-n. Gjithashtu, shoqëria duhet të dokumentojë mbi informimin e MIE-s në lidhje me ecurinë e projektit në referencë të përcaktimeve të kontratës dhe të afateve të vendosura në nenin 9 të saj;

- Mbështetja financiare për të dokumentuar aftësinë për të realizuar pjesën e mbetur të investimit, sipas informacionit të dhënë nga shoqëria mbi mënyrën e financimit të projektit;

- VNM-n paraprake të re.

- Në nenin 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë ose organ tjetër (çështja paraprake), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.

- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet që të pezullohet deri më 13.3.2025 vendimarrja e Bordit mbi kërkesën e shoqërisë “Driben” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

deri në depozitim në ERE të VNM-së paraprake të re, dokumentacionit vërtetues për mbështetjen financiare për vlerën e mbetur të investimit dhe njoftimet përkatëse drejtuar MIE-s, në lidhje me ndryshimin e vlerës së investimit të projektit dhe mbi ecurinë e realizimit të tij.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë deri më 13.3.2025 vendimmarrjen mbi kërkesën e shoqërisë “Driben” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet prodhues 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Brenda datës 21.2.2025, shoqëria duhet të depozitojë në ERE: VNM-në paraprake të re, dokumentacionin vërtetues për mbështetjen financiare për vlerën e mbetur të investimit dhe njoftimet përkatëse drejtuar MIE-s, në lidhje me ndryshimin e vlerës së investimit të projektit dhe mbi ecurinë e realizimit të tij.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Driben” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti